

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



MËSIME TË NDRITURA

(Përzgjedhje thëniesh nga Imam Sejid Ali Khamenei)

I përzgjedhi dhe i përktheu: **Sheh Vullnet Merja**

Tiranë, 2023

Titulli: **Mësime të ndritura**

(Përzgjedhje thëniesh nga Imam Sejid Ali Khamenei)

I përzgjedhi dhe i përktheu: **Sheh Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie Feza**

Kopertina: **Sabrie Feza**

Botues: Shoqata “Flladi”

Hyrje

Historia dëshmon arritjet që kanë arritur shumë persona dhe i ruan dhuntitë e tyre. Në cepat e kësaj historie ka shumë vështirësi dhe mundime, me të cilat përballen njerëzit. Këto vështirësi vazhdojnë ditë pas dite dhe besimtari e gjen veten në një luftë të vazhdueshme me veten dhe me kërkesat e kohës.

Këtu lind pyetja: Cila është rruga dhe mënyra më e duhur për të dalë nga këto labirinte?

Përgjigjja është: Dalja nga këto labirinte arrihet me ndihmën e Allahut, falë udhëheqjes së urtë të Autoritetit të Lartë Fetar (Merxhijeti), në krye të së cilit është Lideri Suprem Ajatullahu Udhma Imam Sejid Ali Khamenei (*Allahu ia shtoftë jetëgjatësinë!*), që ka marrë përsipër të kujdeset për punët e umetit dhe të fesë, deri sa t'ia dorëzojë flamurin Imam Mehdiut (*Allahu ia shpejtoftë ardhjen!*).

Është e drejta e umetit të ruajë udhëzimet e udhëheqjes së mençur, jo vetëm për të ndriçuar rrugët e vështira të jetës, por edhe për të arritur lumturinë.

Ky libër përmban disa mendime të shkurtra nga fjalët e dritës të udhëheqësit të umetit islam, Imam Sejid Ali El Husen Khamenei, të cilat i ka thënë në fjalime të shumta, gjatë takimeve të ndryshme.

Qëllimi i këtij libri është që këto direktiva të vendosen në duart e studiuesit, të mendimtarit, personit të medias dhe kujtdo që dëshiron dhe pëlqen të shohë mendimin e shëndoshë të Imam Sejid Ali Khameneit.

Libri përmban 26 tematika të ndryshme dhe totali i thënieve është 365 thënie rreth fesë, shoqërisë, politikës, moralit etj.

Qoftë ky libër i vlefshëm për lexuesit shqiptarë, në përgjithësi dhe për besimtarët në veçanti! Allahu na mbarësoftë, na faltë dhe na mëshiroftë!

Shoqata “Flladi”

Profetësia dhe qëllimi i profetëve (*Paqja qoftë mbi ta!*)

Profetët, nga i pari e deri tek i fundit, përfshirë edhe Profetin më fisnik (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e kishin të përcaktuar qëllimin e misionit të tyre. Qëllimi i misionit ishte: t'i pastrojnë njerëzit, t'u mësojnë atyre Librin dhe urtësinë.

Thirrja e profetëve e fton njeriun që të jetë i vetëpërmbytur nga kënaqësitë.

Kushtetuta e parë dhe e fundit e profetëve është devotshmëria, e cila sjell mëshirë dhe udhëzim hyjnor për individin dhe shoqërinë e devotshme.

Profetët janë ata që përhapën në mbarë botën, me të gjitha energjitë e tyre, mesazhin e çlirimit të njeriut dhe të vetëdijes së tij dhe për këtë sakrifikuan çdo gjë të çmuar dhe të shtrenjtë. Ata i ofruan njeriut një rrugë që e çon me qetësi

dhe kthjelltësi në Xhenetin e Ahiretit, duke kaluar nga jeta e dynjasë.

Profetët e paralajmëruan njeriun për pasojat e shpërdorimit të talenteve dhe për rrezikun e rrëshqitjes në thellësitë e moçalit të shkatërrimit moral. I mësuuan njeriut përmendjen e Allahut dhe dashurinë e Tij, duke i siguruar atij arritjen e lartësisë që ai as mund ta imagjinojë.

Profetët shpërthyen te njeriu burimet e virtytit, të ndershmërisë, besueshmërisë, dashurisë. Por jo vetëm kaq, por edhe burimet e punës, krijimtarisë, shkencës dhe njohjes.

Profetët i mësuuan njeriut se si të forcojë krahun e tij për të mbrojtur vlerat dhe për të bllokuar rrugën përballë djajve të këqij, shkatërrimit dhe rënies.

Profetët e mësuuan njeriun, që të mos i bëjë padrejtësi askujt e të mos i nënshtrohet padrejtësisë, madje ai duhet të ngrihet për të vendosur drejtësinë.

Thirrja e profetëve, që në fillim, ishte adhurimi i Zotit dhe shmangia e tiranit. Nëse jemi dëshmitarë të intensifikimit të armiqësisë së fuqive të mëdha ndaj fesë së Allahut dhe flamurit të mesazhit hyjnor, le ta dimë se kjo është çështje e natyrshme dhe e përhershme.

Misioni i madh i profetëve ishte që t'i njihnin njerëzit me qëllimin përfundimtar dhe më të lartë, t'i udhëzonin, duke u thënë atyre se rruga e drejtë është rruga drejt Allahut të Madhëruar.

Vështrimi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) nuk kufizohej vetëm në një moment të caktuar, por ishte për të gjithë historinë.

Të dashurit e mi! Djeni se ekziston një element shumë i çmuar dhe i shtrenjtë në ekzistencën tuaj dhe të gjitha përpjekjet e bëra nga profetët kishin një qëllim, që ne të mundohemi ta pastrojmë nga papastërtitë atë element të çmuar në brendinë tonë.

Sipas Islamit, bota po ecën drejt qeverisjes dhe drejtësisë së vërtetë. Profetët erdhën për t'i udhëhequr njerëzit në këtë rrugë të gjerë, në të cilën, nëse shkelnin, energjitë e tyre do të shpaloseshin automatikisht.

Mësuesit shpirtërorë të njerëzimit, pra, profetët dhe imamët e udhëzimit, gjithmonë kanë mbajtur çekiçin për t'i goditur kokën këtij "gogoli", të cilin ne e quajmë nefsi.

Ngritja e profetëve të Allahut, shpallja e Librit dhe ekuilibri hyjnor ishin për t'i shpëtuar njerëzit nga presioni i shtypjes, diskriminimit dhe vendosjes së kufizimeve, në mënyrë që ata, nën sistemin e drejtësisë, të ecin drejt përsosmërisë së tyre njerëzore.

Kudo që të shikoni, do t'i gjeni mësimet e profetëve (*Paqja qoftë mbi ta!*). Edhe pse u përballën me padrejtësitë, mësimet e tyre vazhdojnë edhe në ditët e sotme.

Të gjitha moralet e mira dhe emërtimet e bukura, si: drejtësia, pajtimi, reformimi etj, janë për shkak të mësimëve

të profetëve dhe arsyeja për këtë është se ata nuk ndienin lodhje dhe nuk tërhiqeshin.

Drejtësia ishte qëllimi i dëshiruar i misionit të profetëve, për të vendosur qeverisjen hyjnore.

Profetët i kundërshtonin dhe ngriheshin kundër regjimeve tiranike që sundonin shoqërinë. Kështu që ata detyroheshin të përfshiheshin në konflikt e ndonjëherë edhe të formonin ushtri.

Nuk ka ndalesa në sistemin profetik, por ka lëvizje të vazhdueshme dhe përparim të përhershëm.

Misioni i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte një lëvizje praktike, për ta çuar njerëzimin drejt përsosjes individuale, shpirtërore dhe morale nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, drejt përparimit të jetës shoqërore dhe reformimit të shoqërisë.

Profetët dhe të dërguarit bënë një luftë të gjatë dhe të mundimshme për përhapjen e mesazhit hyjnor. Ata dhanë shembuj të shkëlqyer të sakrificës, për hir të besimit dhe fesë, kështu që ajo mbeti e pavdekshme në mendje.

Profetët nuk erdhën vetëm për t'i këshilluar njerëzit. Predikimi dhe këshillimi konsiderohen si një aspekt i punës së tyre, të cilët, të gjithë, u dërguan për të ndërtuar një shoqëri të bazuar në vlera hyjnore.

Profetët e Allahut

Profetët e mëdhenj të Allahut i luftonin qeveritë, autoritetet, tiranët, të pasurit, sunduesit e pasurive të shoqërisë.

Doktrina e monoteizmit, me të gjitha bekimet që ajo përmban, ka nevojë për ndriçim, i cili nuk mund të sigurohet veçse përmes rrugës së një intelekti të udhëzuar nga Shpallja hyjnore.

Nëse i hidhni një sy kohës së të gjithë profetëve, do të shihni se të gjithë, pa përjashtim, triumfuan ndaj arrogantëve.

Historia e Profetit Musa (*Paqja qoftë mbi të!*) është një nga tregimet më shprehëse dhe më të mrekullueshme. Të flasësh për të, është mësim e krenari dhe nuk arrin t'i shprehësh të gjitha qëllimet e saj, sado e gjatë dhe e degëzuar të jetë.

Gjëja e parë që bënë arrogantët kryeneçë, kur u përballën me profetët, ishte tallja dhe përçmimi i tyre, përfshirë këtu edhe profetët e mëdhenj, si: Isai, Musai, Ibrahim, Nuhu etj.

Isai (*Paqja qoftë mbi të!*), Profeti i Allahut

Ajo Fjalë e Allahut, Mesihu, djali i Merjemes, mbajti mbi supet e tij flamurin e udhëzimit të njerëzve dhe shpëtimin e tyre në kohën e humbjes, të injorancës, nënçmimit të vlerave njerëzore. Ai luftoi tiraninë, arrogancën, paragjykimet dhe padrejtësinë. Ishte i palëkundur në rrugën e përhapjes së drejtësisë, mëshirës dhe monoteizmit. Besimtarët, myslimanë dhe të krishterë, duhet të kthehen te mësimet e profetëve, për të pasur një sistem të përshtatshëm mbarëbotëror. Ata duhet të përhapin virtytet njerëzore, bazuar në mësimet e profetëve, që janë mësuesit më të mëdhenj të humanizmit dhe të vlerave të larta njerëzore.

Rëndësia e Mesihut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) në Islam nuk është më e paktë se sa rëndësia dhe vlera e tij në sytë e besimtarëve të krishterë. Gjithë jetën e tij, ky Profet i madh qëndroi në mesin e njerëzve dhe përballë padrejtësisë dhe të padrejtëve, përballë agresivitetit dhe shkatërrimit, agresorëve dhe shkatërrimtarëve, të cilët shfrytëzonin pasurinë dhe fuqinë për të skllavëruar popujt. Ai, që kur lindi, për hir të Allahut, përballoi të gjitha hidhësitë.

Myslimanët thonë se Merjemja simbolizon pastërtinë dhe ndershmërinë, pra, ajo është plotësisht femër e pastër. Ka disa ajete në Kur'an, që flasin për Merjemen (Marinë), si për shembull: **“Merjemja, e bija e Imranit, që e ruajti nderin e saj dhe në të i frymë nga Shpirti Ynë”**. (Sure Tahrim, ajeti 12). Ajo ishte në gradën e pagabueshmërisë. Si arriti ajo në këtë shkallë? Për mendimin tim, kjo është shumë e rëndësishme. Cilët ishin faktorët që një vajzë e vogël të hyjë në tempull dhe të qëndrojë aty deri në moshën e rinisë dhe t'i rezistojë pëshpëritjeve? Nëse ajo fuqi nuk do të ishte mbi fuqinë njerëzore, Kur'ani nuk do të thoshte: “e ruajti nderin dhe pastërtinë e saj”. Kjo është shumë e rëndësishme dhe është një mësim për të gjithë ne.

Shpresa jonë është që të gjithë ndjekësit dhe të gjithë ata që besojnë Mesihun (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe pozitën e tij të lartë, të ndjekin shembullin e tij dhe të veprojnë sipas urdhërimeve dhe mësimave të tij.

Udhëzimi i Isait, i biri i Merjemes (*Paqja qoftë mbi të ta!*), është adhurimi i Allahut dhe nxitja për t'u përballur me faraonët dhe tiranët.

Ata që zhurmojnë me ndjekjen e këtij të dërguari të nderuar të Allahut (Isai) janë ulur sot në kolltukun e faraonëve dhe të tiranëve, të cilët i luftoi Isai, i biri i Merjemes (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Ehli Bejti *(Paqja qoftë mbi ta!)*

Ehli Bejti i Profetit është epiqendra e të gjithë myslimanëve dhe të gjithë myslimanët i duan ata.

Ehli Bejti është emblema dhe flamuri që tregon Islamin e vërtetë e të pastër nga devijimi.

Vërtet, dashuria për Ehli Bejtin është një dukuri e përbashkët mes myslimanëve, në të shkuarën dhe në të tashmen.

Sigurisht, medh'hebi i Ehli Bejtit është medh'heb i argumentimit dhe i maturisë arsyetuese.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*)

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), është një e vërtetë e mahnitshme. Nëse ne nuk njohim ndonjë aspekt të personalitetit të tij, identiteti ynë do të shtrembërohet.

Nëpërmjet paraqitjes së personalitetit të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ne mund të ndriçojmë mendjet dhe zemrat e njerëzve të kohës sonë, në lidhje me çështjen themelore të Islamit.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), është shembulli i vërtetë i çdo njeriu të dëshpëruar, i cili dëshiron të ngjitet në atë që e lartëson mbi të gjitha krijesat e këtij universi.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), është prej personaliteteve tërheqëse të historisë. Rrallë gjen

një figurë historike, me të cilën njerëzimi ka rënë në dashuri, siç është personaliteti i Prijësit të besimtarëve, Ali ibn ebu Talibi (*Paqja qoftë mbi të*).

Të drejtët dhe mendjemprehtët janë të dashuruar me personalitetin e madh të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Kushdo që ka dëgjuar diçka për Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), shikon karakteristikat dhe cilësitë e larta njerëzore te ai.

Ka jomyslimanë që nuk e pranojnë Islamin, por e duan, e respektojnë dhe e lavdërojnë Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*).

Njerëzimi ka nevojë për cilësitë që Prijësi i besimtarëve kishte ngritur flamurin e tyre, sepse ato nuk zhduken, pavarësisht përparimit të shkencës dhe të teknologjisë.

Nëse bota islame, madje e gjithë bota, i pohon virtytet e Aliut, atëherë kjo i atribuohet atij, personalitetit të tij, që karakterizohet nga asketizmi, adhurimi, guximi dhe qëndrueshmëria në rrugën e Allahut.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte manifestim i udhëheqjes në Islam dhe kujdestar i besueshëm. Për asnjë moment nuk ishte larg njerëzve, por gjithmonë ishte në komunikim e në harmoni me ta.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte mishërim i kohezionit të liderit politik, të kujdestarit dhe të imamit me anëtarët e popullit. Nuk mund të gjendet një shembull më i qartë në të gjithë botën dhe gjatë historisë si Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*).

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ia kushtoi jetën e tij, çdo orë e të cilës është e barabartë me moshën e një njeriu, drejtimit dhe ndërtimit të shoqërisë në kohën e tij, të shoqërisë islame dhe njerëzore gjatë historisë.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), është shembull i plotë për të gjithë dhe rinia e tij, e cila qe e mbushur me energji e entuziazëm, është model për rininë.

Emri i Prijësit të besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), është i dashur për të gjithë dhe populli ynë e do këtë njeri të madh.

Personalitetin e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk mund ta kuptojë mendja, intelekti dhe të kuptuarit e zakonshëm, sepse çdo gjë në qenien e tij ishte plot me mrekulli.

Ditët dhe vitet, madje historia, në tërësinë e saj, është e lidhur me Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), me vijën dhe qasjen e tij ndriçuese.

Drejtësia, të cilën ne e konsiderojmë si ndër parimet e fesë, kërkoi që Allahu i Madhëruar të zgjidhte një person si Prijësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*), për ta udhëhequr dhe për ta udhëzuar umetin.

Prania e Prijësit të besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*), e personalitetit të tij, e edukatës dhe e madhështisë së tij, si dhe emërimi i tij si udhëheqës, janë të gjitha manifestime të drejtësisë së Allahut. Drejtësia, në kuptimin njerëzor, u mishërua në formën e saj më të plotë në qenien e tij.

Nata e martirizimit të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), e cila është natë zimbajtjeje dhe fatkeqësi për të gjithë myslimanët, u shndërrua në natë triumfi, gëzimi dhe fitoreje për të.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte manifestim i përparësive, të cilat, nëse i mishërojmë në fjalët dhe veprimet tona, shoqëria jonë islame do të arrinte majat e lavdisë.

Prijësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili u mallkua për gati njëqind vjet në minbere dhe u keqtrajtua në të gjithë botën islame, pas kalimit të këtyre viteve të gjata, arriti të dalë nga rrënojat e këtyre iluzioneve, duke udhëzuar historinë.

Disa tipare morale të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), janë shumë të larta, të cilat janë të pakuptueshme për ne. Ne i besojmë ato cilësi dhe krenohemi me to, sepse i kemi dëgjuar nga i vërteti dhe vërtetuesi, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Gjëja më e rëndësishme, në të cilën përqendrohej Prijësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte që udhëheqësi të mos e kishte qeverinë një mjet jetese, fitime financiare dhe grumbullim të pasurisë.

Prijësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të*) është shprehur i gatshëm për të përballuar kushtet më të errëta dhe më të ashpra, për të mos e takuar Allahun e Madhëruar, duke qenë i padrejtë ndaj një robi prej robëve të Tij.

Sipas Prijësit të besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*) pozita qeverisëse nuk duhet të shndërrohet në mjet për të siguruar rehati, jetesë dhe përfitime të kësaj bote, sepse nuk është një profesion si profesionet e tjera.

Sikur t'i jepej mundësia Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ai do të ndërtonte një botë të begatë, materialisht dhe moralisht, të drejtë, të qëndrueshme, të paqtë, të cilën njerëzimi nuk e ka parë kurrë një të tillë.

Mishërimi më i mirë i veçorive të qeverisjes hyjnore është Prijësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili gjatë udhëheqjes së tij ishte modest, por jo i dobët dhe mendjemadh.

Zbatimi i fesë së Allahut është karakteristika e parë e qeverisë alevite, nga e cila buron drejtësia e fesë, pushteti i popullit dhe mirësjellja ndaj njerëzve. Këto e karakterizojnë jetën e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*).

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), nuk e toleronte padrejtësinë dhe nuk mbështetej në të, edhe nëse interesat e tij shkonin dëm.

Qeverisja e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), rrjedh nga vullneti i umetit, pasi ai nuk arrinte

as ta mendonte dhe jo më t'i udhëhiqte njerëzit përmes dominimit dhe nënshtrimit.

Rruga e drejtë e atyre që e ndjekin Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), është t'i vendosin para syve tiparet e pushtetit alevit, aq sa ai është i fortë dhe i aftë.

Qeverisja e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), dallohet për drejtësi dhe paanësi. Ajo ishte dhe është model për pushtetarët. Jo vetëm kaq, por jeta e tij e tejmbushur me xhihad dhe përgjegjësi ishte dhe është model për të gjithë besimtarët.

I vetmi shqetësim, që e mërziste Prijësin e besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte gjendja e umetit, e shoqërisë, rrugëtimi i fesë dhe drejtimi fetar në sistemin islam.

E singerta e madhe, Fatime Zehraja

(Paqja qoftë mbi të!)

Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) është personalitet i lartë dhe ka një pozitë madhështore në histori. Ajo, megjithëse jetoi pak, arriti në gradën e eulijave.

E gjithë jeta e Fatimes (*Paqja qoftë mbi të!*), në të gjitha dimensionet, ishte e mbushur me punë, me përpjekje, me përsosmëri dhe me lartësim shpirtëror.

Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte për Profetin tonë fisnik si “nënë”, këshilltare dhe shëruese e plagëve. Për këtë, ajo është quajtur si “nëna e babait të saj”.

Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) është vajza e Profetit më madhështor, bashkëshortja e imanit më të devotshëm dhe nëna e dy trëndafilave më të bukur.

Përkujtimi i Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) ka kuptimin e përkujtimit të punës, heroizmit dhe sakrificës.

Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) është modeli më i përkryer jo vetëm për femrën myslimane, por për mbarë njerëzimin.

Zonja e nderuar, Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*), arriti në këtë shkallë të lartë nëpërmjet përpjekjeve dhe veprave të saj dhe jo se ishte e bija e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Fatime Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*) është modeli i femrës që dëshiron Allahu i Madhëruar.

Jo vetëm personaliteti i Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) ngjall habi dhe hutim, por edhe madhështia e mesazhit që paraqiti.

Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*) është një “planet”, drita e mrekullueshme e të cilit do të shkëlqejë gjatë gjithë kohës.

Nëse i hiqni të gjitha kufizimet që mund të rrethojnë femrën, atëherë mund të shihni madhështinë që kjo zonjë e nderuar tregoi gjatë jetës së saj, edhe pse e shkurtër.

Dimensionet ekzistenciale të kësaj hyrie njerëzore dhe e shpirtit të pastër e të gjerë janë të vështira për t'u kuptuar.

Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*) është një agim i ndritshëm, në anën e të cilit shkëlqen dielli i Imamit (i Udhëheqjes) dhe i Profecisë. Ajo e priti martirizimin e saj të madh me zemërgjerësi.

Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*) është një qiell i lartë, në të cilin përfshihen yjet e ndritshëm të udhëheqjes.

Ylli i botës së ndritur nuk është ai që shohim dhe imagjinojmë. Ne e shohim dritën e personalitetit të Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*), madje ajo është shumë më e madhe se kaq.

Fatimja fisnike (*Paqja qoftë mbi të!*), pjesë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), është shembull për gratë dhe burrat gjatë gjithë historisë së Islamit.

Imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*)

Imam Hasan El Muxhteba (*Paqja qoftë mbi të!*) u detyrua të pranonte besëlidhjen me Muavijen për interesin më të madh, për të ruajtur Islamin e gjyshit të tij. Ai kishte 2 mundësi para vetes për të zgjedhur: ose të martirizohej, ose të jetonte. Të qëndruarit i gjallë ishte më shpërblyese, më e dobishme dhe më e vështirë se vrasja. Imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) zgjodhi rrugën e vështirë, përballjen me tiraninë.

Jeta dhe puna, në një atmosferë të tillë, u bënë shumë më të vështira se vrasja, martirizimi dhe takimi me Allahun, por Imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) vazhdoi këtë rrugë më të vështirë.

Goditja më e madhe dhe më e ashpër që i është dhënë Islamit, në fillimet e tij të para, ishte transformimi i qeverisë islame nga imamat (udhëheqje) në sulltanat (sundim), pasi

qeveria e Imam Hasanit (*Paqja qoftë mbi të!*) shkoi në Sham (Damask), nën sundimin e Muaviut të birit të Ebu Sufjanit.

Imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk u rebelua kundër Muavijes, jo se ai nuk ishte i aftë për këtë, por kushtet nuk ishin të përshtatshme për ta bërë këtë veprim.

Lërinin të rinjtë tanë të gjejnë modelin e tyre, sepse më e mira për të rinjtë është modeli nga vetë rinia. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "*Hasani dhe Hysejini janë zotërinjtë e të rinjve të banorëve të Xhenetit*".

Imam Hasanit (*Paqja qoftë mbi të*) ia grabitën imamatin (udhëheqjen). Kur qeveria devijoi nga boshti i saj fetar dhe u fut nën kontrollin e kërkuesve të kësaj bote dhe të njerëzve të saj, ishte e qartë se do të ndodhte ngjarja e Kerbelasë.

Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*)

Hysejn ibn Aliu është flamuri i drejtësisë dhe i vlerave shpirtërore, edhe pse kanë kaluar afërsisht katërmëdhjetë shekuj.

Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*) është pamja e fuqisë. Rezistenca e tij u bë burim i madhështisë dhe i krenarisë. Kjo është krenaria dhe madhështia Hysejiane.

Emri i Hysejn ibn Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) është emër i habitshëm. Nëse do të hidhnit një vështrim, do të gjenit se e veçanta e këtij imami, në mesin e myslimanëve, është animi i zemrave të tyre kah ai.

Allahu i Madhëruar ka bërë që emri i imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) të ndikojë te të tjerët. Nëse e kujton atë (imam Hysejnin), shpirti dhe zemra mbushet me forcë.

Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*) i dha një mësim praktik e madhështor historisë islame dhe siguroi qëndrueshmërinë e Islamit jo vetëm në kohën e tij, por në çdo kohë.

Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*) e përçoi mesazhin e tij në situatën më të vështirë, me qëllim që askush të mos justifikohet, nëse përballet me situata të vështira e të ashpra.

Falë revolucionit dhe gjakut të imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) Islami u ringjall dhe bashkë me të edhe liria.

Duhet të thuhet se drita e Hysejnit, i biri i Aliut, shkëlqen si dielli në këtë ekzistencë.

Jini Hysejnianë dhe ecni në rrugën e Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*)! Dijeni se ajo është rruga e lumturisë në dynja dhe në Ahiret. Allahu do t'ju ndihmojë në këtë rrugë.

Palëkundshmëria e imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte një prej faktorëve të mëdhenj dhe të veçantë në Revolucionin e Ashures.

Durimi i imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) e mbrojti Islamin përgjatë historisë dhe vazhdon ta mbrojë edhe në këtë kohë.

Imam Hysejni i dha një mësim të përjetshëm historisë islame dhe ai është: Çfarë duhet bërë dhe çfarë qëndrimi duhet të mbahet, kur Islami përballet me rrezik.

Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*) refuzoi të firmosë besëlidhjen e zezë të Jezidit, duke thënë: “Një si unë nuk ia jep besën një të tilli, si Jezidi”.

Lëvizja e imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte lëvizje e forcimit të vërtetës, forcimit të fesë, forcimit të udhëheqjes dhe e forcimit të asaj vije që vizatoi Profeti i Zotit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*) u përball me sfidat e përgjegjësisë e të udhëheqjes përgjatë dhjetë viteve. Ai ushtroi aktivitete të tjera, të cilat nuk janë të ngjashme me martirizimin në Kerbela.

O bijtë e umetit tonë islam! Mësimet e imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) janë pronë e të gjithë myslimanëve, në çdo brezni. Lëvizja Hysejniane, në çdo kohë, siguron qëndrimin e Islamit, krenarinë dhe fuqinë e myslimanëve.

O ju besimtarë që ndiqni imam Hysejnin (*Paqja qoftë mbi të!*), mos i lini konceptet e gabuara e të kota që të largojnë sytë dhe zemrat nga fytyra e ndritur dhe e begatë e zotërisë së dëshmorëve!

Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*) e kreu këtë detyrë (revolucionin), sepse situata e kësaj vepre ishte e përgatitur në kohën e tij.

Hysejni, i biri i Aliut (*Paqja qoftë mbi ta!*), në një kohë shumë të ndjeshme në historinë e Islamit, përcaktoi detyrën

më kryesore në mesin e detyrave të shumta, që kanë shkallë të ndryshme për nga rëndësia. Ai, në deklaratën e tij, e bëri të qartë për të gjithë se detyra më e rëndësishme e botës islame është lufta me kreun e pushtetit tiran.

Lëvizja e imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ka asnjë të metë, qoftë sa maja e gjilpërës, prandaj ai ka qenë, është dhe do të mbetet i pavdekshëm përgjithmonë.

Në Revolucionin e imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk gjendet fraza “unë” apo interesa personale, fisnore e partiake.

Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*), edhe pse ishte në fushën e betejës e të vrasjes, i fliste Allahut me gjuhën e dashurisë, të kënaqësisë dhe mirënjohjes.

Sikur të mos ishte besimi, singjeriteti dhe drita hyjnore në zemrën e imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*), e cila dërgonte energji në zemrat e shokëve të tij, kjo ndodhi nuk do të realizohej.

Kudo që besimtarët sakrifikues, burra e gra, ndjekin gjurmët e imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) shpirtëroja, e kristalizuar në thellësi të qenieve njerëzore dhe sekretet e tyre do të triumfojnë mbi ushtarët e shejtanit.

Lufta e imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) kundër Jezidit nuk ishte kundër Jezidit si individ i vdekshëm e i pavlerë, por ishte kundër injorancës njerëzore, degradimit, devijimit dhe poshtërimit.

Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*) është kulmi i njerëzimit në thirrjen për liri, drejtësi, rezistencë ndaj të këqijave dhe shëmtive, për luftimin e injorancës dhe poshtërimit.

Sjellja e imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) përfshinte moralin, krenarinë dhe madhështinë. Në të njëjtën kohë, ai bënte një jetë të përkorë dhe i nënshtrohej urdhrit të Allahut.

Kush është i destinuar të takohet me Zotin, le të udhëtojë me imam Hysejnin (*Paqja qoftë mbi të!*). Atij nuk i lejohet të qëndrojë në shtëpi, të jetë i lidhur me dynjanë dhe

me kënaqësitë e saj dhe të jetë i shkujdesur ndaj rrugës së imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Kur dashuria rrënjohet, ajo trashëgohet, njësoj si tiparet e njeriut dhe përcillet brez pas brezi. E tillë është dashuria për imam Hysejnin (*Paqja qoftë mbi të!*).

Lidhja me imam Hysejnin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të kuptuarit e konceptit të martirizimit, mbështet jetën materiale dhe morale të njeriut.

Lëvizja profetike dhe lëvizja Hysejniane janë si dy rrathë të qendëruar, duke shkuar drejt një rrugëtimi të përbashkët.

Zonja Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*)

Zonja Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*), me qëndrueshmërinë e saj, ruajti Islamin. Pikërisht, kjo qëndrueshmëri u kthye në simbol dhe faktor thelbësor për të tjerët.

Zonja Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*) qëndroi e vetme përballë një bote të keqe dhe të padrejtë.

Zejnebul Kubra (*Paqja qoftë mbi të!*), e bija e Fatimes (*Paqja qoftë mbi të!*), kur ishte robinjë, u përball me sulltanët më të fuqishëm të kohës së saj.

Pozita e Zonjës Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*) vjen pas pozitës së imamatit.

Është qesharake e vulgare që vajzat e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të çohen e të shëtiten nëpër tregje dhe rrugë dhe të ofendohen dhe në mesin e tyre ishte një grua si Zejnebi.

Zejnebi (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ishte imame, por Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*) e edukoi atë në një edukatë të mirë gjatë atyre viteve të shkurtra.

Shpresoj që gratë dhe vajzat e nderuara të nxjerrin mësim nga jeta e Zonjës Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*).

Nuk mendoj se dikush ka kaluar ditë më të vështira siç i kaloi Zejnebi (*Paqja qoftë mbi të!*).

Mbulimi (hixhabi)

Gruaja myslimane është ajo që kujdeset për fenë e saj, mbulesën, butësinë e saj. Jo vetëm kaq, por ajo mbron të drejtat e saj. Sulmi i armiqve të fesë në Perëndim ndaj mbulesës islame është dëshmi e dëshirës së femrës dhe i kapjes fort pas mbulesës.

Ne i ftojmë gratë në dëlirësi, mbulim dhe mospërzierje me gjininë tjetër, sepse te mospërzierja gjendet dinjiteti për gratë myslimane.

Gratë iraniane morën pjesë në aktivitete shoqërore dhe ndihmuan në zhvillimin e vendit me punën e tyre të palodhur, kur dolën në shesh, duke veshur hixhabin.

Pedagoget dhe profesoreshat duhet ta përhapin kulturën dhe frymën islame në mjedisin universitar dhe të mos lejojnë të cenohet shenjtëria e mbulesës.

Nuk duhet të neglizhohet aspekti i dëlirësisë e i nderit te gruaja, që është elementi më i rëndësishëm i personalitetit të saj.

Dëlirësia dhe nderi i një gruaje janë mjet për ta nderuar atë dhe për të ngritur pozitën e saj në sytë e të tjerëve.

Çështja e hixhabit, si për vendasit, ashtu edhe për të huajt, nuk është vetëm për hir të ruajtjes së dëlirësisë.

Udhëheqja (El Uilajetu)

Shtylla kryesore e qeverisjes islame është që personi që udhëheq popullin, të jetë nga gjiri i popullit.

Realiteti i udhëheqjes hyjnore pasqyrohet përmes marrëdhënieve me popullin.

Vilajeti për të cilin ka folur Profeti i Islamit është një urdhër hyjnor.

Caktimi i Prijësit të besimtarëve, imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), si udhëheqës e mëkëmbës, është aq i rëndësishëm, sa që moszbatimi i tij është i barabartë me moszbatimin e Mesazhit.

Kuptimi i udhëheqjes (el uilajetu) përbën një nga pikat themelore dhe të ndjeshme, për të cilën duhet të mendojnë bijtë dhe mendimtarët e shoqërisë sonë islame.

Udhëheqja (el uilajetu) është karakteristikë prej karakteristikave të shoqërisë islame, e cila ka jetuar nën hijen e udhëheqjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe shoqëria e merr kuptimin e saj duke parë udhëheqjen profetike.

Të gjitha atomet e ekzistencës, duan apo nuk duan, rrotullohen brenda kornizës së vilajetit të Allahut.

Nëse myslimanët e botës dhe popujt e vendeve islame do të ngrinin sot parullën e udhëheqjes islame, do të hapeshin kyçet e shumta dhe do të zgjidheshin dilemat.

Gadiri

Emërtimi i ditës së festës së Gadirrit si Dita e vilajetit është emërtim i saktë, pasi është dita në të cilën koncepti i udhëheqjes (el uilajetu) u vërtetua dhe u konkretizua nga vetë dora e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Çështja e Gadirrit është një çështje islame, jo vetëm një çështje shi'ite.

Ndodhia e Gadirrit është shumëdimensionale dhe myslimanët mund ta përdorin atë si mjet për përparimin e botës islame.

Ajo që mund të kuptohet nga ndodhia e Gadirrit, është përmbajtja e atij caktimi hyjnor për konceptin e menaxhimit të punëve të vendit, duke zgjedhur të drejtët punëmirë për të marrë përgjegjësitë e mëdha.

Gadiri është themeli i doktrinës dhe i parimeve tona shi'ite.

Ndodhia e madhe historike e Gadirit nuk duhet të mendohet si një ngjarje e një sekti fetar, por ajo përfaqëson vazhdimësinë e vijës së të gjitha mesazheve hyjnore.

Ndodhia e Gadirit buron nga fryma dhe përmbajtja e vërtetë e Islamit.

Shi'izmi

Shi'izëm do të thotë ndjekje, pasim. Nëse nuk realizohet kjo ndjekje e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), atëherë pretendimi se jam prej pasuesve të tij, do të jetë padrejtësi ndaj Prijësit të besimtarëve.

Islami është fe logjike dhe kuptimi shi'it për Islamin është më logjik se kuptimet e tjera.

Ne, shi'itët, jemi njerëz të logjikës dhe njerëz të argumenteve logjike. Edhe librat për shi'itët janë plot me argumente të forta logjike.

Besimi në imamat (udhëheqje) është baza për përfshirjen e një individi ose grupi në medh'hebin shi'it.

Botimi i librave që dëmtojnë shi'itët dhe shpërndarja e tyre nëpër vendet e botës, dëmton doktrinën dhe historinë e tyre. Kjo teknikë i shërben qëllimeve dhe ambicieve të të huajve.

Ashurja

Ashurja është moto që përçon te njeriu entuziazëm, lëvizje dhe zhvillim mendor. Ajo nuk është parullë boshe.

Ceremonia e përkujtimit të Ashures përmban ide, planifikim, qëllim, largpamësi dhe njohje.

Ajo që ndodhi më 10 Muharrem, është e rrallë në historinë e njerëzimit. Njerëzimi as nuk ka parë e as nuk ka për të parë ndodhi të tillë gjatë gjithë ekzistencës së tij.

Ndodhia e Ashures është ndodhi hyjnore, edhe pse është e përzier me luftë, vrasje, martirizim dhe gjakderdhje.

Mësimet e nxjeria nga Ashurja nuk janë mësimet vetëm për një periudhë kohe, por janë mësimet të gjalla e të përjetshme.

Ashurja na mëson se vigjilenca është e domosdoshme për njeriun, për të mbrojtur fenë e tij. Ashurja na mëson se ballafaqimi me armikun është i mundshëm, edhe pse ai zotëron fuqi të mëdha, siç ishte ushtria emevite.

Lind pyetja: Çfarë dobie fitohet nga ripërtëritja e kujtimit të Ashures dhe nga organizimi i tubimeve për imam Hysejnin (*Paqja qoftë mbi të!*)?

Përgjigjja është: Ashurja është një mirësi e madhe. Ajo lidh drejtpërsëdrejti zemrat me Allahun dhe forcon besimin në të padukshmen (gajbin). Përgjatë historisë, Ashurja i ka bërë udhëheqësit e padrejtë dhe tiranë të dridhen nga frika prej saj dhe prej vendvarrimit të imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo frikë ka filluar që në kohën e Beni Umejes dhe vazhdon edhe sot.

Qëllimi që përmban revolucionin e imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*), është qëndrimi përballë padrejtësisë dhe tiranisë. Për këtë qëllim të shenjtë, imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) duroi format më të ashpra të xhihadit dhe të konfliktit me armiqtë e Allahut.

Të përkujtohet ndodhinë e Ashures, nuk do të thotë të përmendesh disa kujtime dhe ndodhi që kanë ndodhur në të. Ashurja është sqaruese e një ngjarjeje shumëdimensionale, që ka lënë gjurmë të thella dhe ka ndikuar në jetën e umetit islam gjatë gjithë historisë.

Ashurja nuk është vetëm ndodhi historike. Ajo është kulturë dhe lëvizje e vazhdueshme. Është shembull i përjetshëm për umetin islam, sepse revolucionin e imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) përbëhet nga: logjika, intelektin, optimizmi nxitës për krenari dhe dhembshuri.

Ashurja është mësim për sakrificën, besimin, besnikërinë dhe trimërinë. Ajo është mësim për të vepruar për hir të Allahut. Është mësim për dashurinë dhe përmallimin.

Nëse dëshirojmë të përmendim dy ose tri cilësi të dalluara nga mesi i të gjitha atyre cilësive të imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*), mund themi se sinqeriteti është njëra prej tyre, që nënkupton respektimin e përgjegjësive hyjnore, duke mos përfshirë në to as interesat personale dhe as motivet materiale. Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ndodhia e Kerbelasë janë ndër ndodhitë historike, ku nuk ka vend egoizmi dhe mungesa e sinqeritetit. Prandaj, kjo vepër jo vetëm që ka mbetur e paharrueshme deri më sot, por do të kujtohet gjithmonë.

Ashurja është fushëbeteja e mësimëve madhështore. Çdo njeri duhet të mendojë në këtë ditë, se në cilën anë ndodhet. A është në anën e drejtësisë dhe të drejtëve apo në anën e padrejtësisë dhe të padrejtëve?

Zonja e madhe Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*) është shembull i lartë në histori. Kjo tregon rolin e madh të femrës në çështjet madhore të Islamit. Në Kerbela, gjaku triumfoi ndaj shpatës. Faktori kryesor i këtij triumfi ishte zonja e madhe Zejneb, e bija e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Pamja e jashtme e fushëbetejës tregonte se drita e Ehli Bejtit në shkretëtirën e Kerbelasë do të shuhej. Mirëpo,

besimi te Allahu bëri të mundur që fjala e drejtë e imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*), që bazohej në realitet, të dilte fitimtare.

Hysejn ibn Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) shkëlqen si diell në mesin e të shenjtëve. Merrni për shembull profetët, të dashurit e të afërmit e Zotit, imamët e pastër dhe dëshmorët, se ata janë si hëna dhe yjet.

Të dashurit e mi! Flamuri i të drejtës nuk qëndron në një rresht me të padrejtën dhe nuk e pranon kontekstin e saj. Kjo është ajo që ka thënë qartë imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*): “I largët është prej nesh poshtërimi”.

Bashkëshortja e Faraonit, në kohën që ishte nën presionin e torturave të Faraonit, tha: “O Zoti im! Më ndërto mua një shtëpi tek Ti, në Xhenet dhe më shpëto prej Faraonit dhe veprës së tij”. Në realitet ajo (Asia) kërkoi vdekjen dhe largimin nga kjo jetë. Ndërsa zonja Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*) në Ditën e Ashures i pa me sytë e saj të gjithë të dashurit e vet të thereshin e të martirizoheshin. E pa me sytë e saj sulmin e armiqve dhe poshtërimin e tyre ndaj gjenezës së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mi të dhe mbi familjen e tij!*). Me gjithë këto fatkeqësi, ajo kurrë nuk tha: “O

Zot më shpëto!" Por: "O Zoti im! Pranoje prej nesh këtë kurban (flijim)!"

Qëllimi i Revolucionit të Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte kryerja e një detyre të madhe, rikthimi i Islamit dhe i shoqërisë islame në rrugën e drejtë. Kjo është vërtetësi madhështore e urdhërimit në të mirë dhe e ndalimit nga e keqja.

Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ka nevojë për këmishë të zezë apo parulla të përsëritura, apo thjesht prani në tubime. Imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*) dëshiron një brez të vetëdijsëm, që e kupton lidhjen me Allahun dhe e kupton se thirrja në rrugën e Tij është më parësorja.

Ndodhia e Ashures na mëson se duhet të sakrifikojmë për fenë e pastër islame dhe për përhapjen e mesazheve të Kur'anit.

Ashurja na mëson se të gjithë njerëzit, pa dallim feje, gjuhe e kombësie, meshkuj, femra, të rinj e të moshuar,

duhet ta kundërshtojnë, me gjithë fuqitë e tyre, të keqen dhe të padrejtën, në çdo kohë dhe në çdo vend.

Jezidi, prijësi i padrejtësisë, i shtrembërimit dhe i humbjes, në vend të udhëzimit dhe edukimit të njerëzve në rrugën e drejtë, kërkonte ta detyronte imam Hysejnin (*Paqja qoftë mbi të!*), që t'i jepte besën atij të padrejti e të pohonte sundimin e tij tiranik. Pikërisht, për këtë arsye ka filluar edhe kryengritja e imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Shiheni Islamin sot. Ai është i gjallë dhe i fortë. E gjitha kjo nga bereqeti i ndodhisë së Kerbelasë dhe martirizimit të imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Prej veçantive të shoqërisë shi'ite është se ata e përmendin ndodhinë e Ashures dhe ditët e dhimbshme të Kerbelasë.

Nëse do të thellohem në ndodhinë e Kerbelasë, që nga momenti kur Abu Abdullahu, imam Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*), doli nga Medina për në Mekë e deri sa u martirizua, do të thoshim se njeriu mund të nxjerrë njëqind mësime të

rëndësishëm nga kjo lëvizje, e cila zgjati vetëm disa muaj. Nuk po them mijëra mësim, edhe pse mund të thuhet. Çdo shenjë treguese e atij Imami madhështor konsiderohet mësim. Kur themi njëqind mësim kam për qëllim njëqind kapituj dhe çdo kapitull është mësim për umetin, për historinë, për vatanin, për edukimin e shpirtit, për administrimin e shoqërisë dhe për t'u afruar te Allahu.

Tubimet e vajtimit, që janë organizuar deri në ditët e sotme, duhet të vazhdojnë përherë, sepse këto lëvizin ndjenjën e dhembshurisë e të dashurisë, me anë të të cilave mund të kuptohen shumë të vërteta, të cilat vështirë se kuptohen jashtë kornizave të kësaj gjendjeje.

Emri Hysejn (*Paqja qoftë mbi të!*) duhet të qëndrojë i gjallë. Gjithashtu, edhe përmendja e Kerbelasë duhet të mbetet e gjallë.

Media

Orientimi i përgjithshëm i medias duhet të jetë drejt reformimit të kulturës së përgjithshme.

Institucionet e specializuara në raportim dhe çështje mediatike, si Organizata e Medies Islame dhe institucionet e lidhura me të, duhet të përpiqen në drejtim të reformimit të kulturës së përgjithshme.

Kur një vepër arti, shkrimi ose imazhi ka një efekt moral shkatërrues, nëse nuk është e mundur që këtyre t'u përgjigjemi, duhet të parandalohen.

Qëllimi i kërkuar i mbikëqyrjes nuk duhet të humbasë mes zhurmës mediatike, e cila bëhet kundër saj.

Mjeti më ndikues në kohën tonë është media.

Akti i parë që ushtron media kundër shteteve, është vënia në dyshim e besueshmërisë së qendrave reale të ndershmërisë dhe pastërtisë në ato shtete. Ato vënë në pikëpyetje natyrën e punës së medieve të ndershme.

Cilado qoftë prej metodave mediatike, artistike që prezantojnë agjencitë informative, ato nuk e plotësojnë predikimin. Nuk dua të them se predikimi nuk ka nevojë për to, por as ato nuk e zënë vendin e predikimit në stilin dhe metodën e tij.

Duhet të ndërmerrni veprime që sigurojnë zgjidhjen e problemeve të pazgjidhshme. Një nga mjetet e rëndësishme të kësaj punës tuaj është media.

Një nga qëllimet e predikimit le të jetë zhvillimi i medieve islame, për të udhëzuar njerëzit.

Hallka e lidhjes mes zyrtarëve dhe popullit është media në përgjithësi dhe shtypi në veçanti.

Shtypi ynë ka përgjegjësinë për të përhapur ndërgjegjësimin e shëndoshë te masat dhe duhet të përpiqet të përhapë vlerat, virtytet dhe idealet që populli dëshiron.

Shtypi ka mundësinë që të rrisë ndërgjegjësimin e masave për përgjegjësitë e tyre dhe t'u tërheqë atyre vëmendjen për përgjegjësitë dhe detyrat e tyre të rrezikshme.

Misioni i shtypit është një qëllim që kërkon një mjet për ta realizuar atë dhe ky mjet është liria. Liria e shtypit duhet të jetë një mjet për të kryer detyrën e shtypit, jo e kundërta, që shtypi të bëhet viktimë e lirisë absolute të dekompozuar.

Me bereqetet e kësaj dite dhe me ngjarjen e misionit (të ardhjes së Profetësisë, Profetit Muhamed), duhet të fillojë një lëvizje e madhe masive, në të cilën predikuesit,

intelektualët, përgjegjësit e medias e të tjerë, të mësojnë dhe të përhapin moralin në mesin e njerëzve.

Duhet të prodhohen filma për të reformuar kulturën e përgjithshme islame. Radioja dhe televizioni duhet të punojnë gjithmonë për kulturën e përgjithshme.

Ne duhet ta rrëfejmë këtë fitore (fitoren e Revolucionit Islamik) dhe ta portretizojmë me të gjitha dimensionet dhe veçoritë e saj. Të rrëfejmë ato mijëra ngjarje e fakte që përmban kjo fitore.

Globalizmi

Çfarë është Globalizmi? Është një grup fuqish ndërkombëtare që përpiket të imponojë kulturën, ekonominë, zakonet dhe traditat e tyre në vendet e tjera të botës.

Nuk ka dyshim në praninë e një nxitjeje të fortë tek ana më e fuqishme e botës së sotme, për të përvetësuar dhe për të dominuar gjithçka në botë me mundësi të thjeshta.

Ekziston një rrjet agjencish, qendrash dhe forumesh ekonomike aktive për të rregulluar ekonomitë e vendeve dhe ekonominë globale, duke u përpjekur të mbledhin pasurinë dhe t'i përvetësojnë ato.

Sot, perëndimorët përsërisin të njëjtën logjikë të determinizmit dhe atë gjykim që as nuk kthehet e as

ndryshon nga konceptet e tyre dhe deklarojnë se nuk ka shpëtim nga globalizimi.

Ju jeni dëshmitarë të urrejtjes për Amerikën në nivel global dhe jeni dëshmitarë të urrejtjes dhe dënimit global, me të cilin përballen qarqet financiare dhe ekonomike dhe ata që ndjekin globalizimin.

Sot ekziston një kërcënim, që përfaqësohet nga ndikimi i drejtpërdrejtë i fuqive të mëdha, me në krye Amerikën, nga njëra anë dhe nga ana tjetër, është ajo rrymë që tiranizon botën dhe quhet Globalizëm.

Shumë nga vendet pjesëmarrëse në konferencat ndërkombëtare i frikësohen globalizimit, sepse e dinë se nuk është gjë tjetër veçse sundimi i Amerikës mbi ekonominë dhe kulturën e vendeve të tjera.

Sot teoricienët dhe propagandistët në Perëndim po përpiqen të kthehen në atë vijë reaksionare, vijën e kthimit në nënshtrim ndaj Perëndimit, nën titullin e teorisë së rinovimit, modernitetit apo globalizimit.

Logjika e re që mbart studenti i universitetit, është logjika e globalizimit, realizmit dhe bashkimit me rendin e ri botëror, pra, varësinë nga Amerika. Emri i këtij rendi botëror, në dukje, është globalizimi, por realiteti i tij është amerikanizimi.

Institucionet perëndimore dhe teoricienët e tij e kanë përshkruar gjithmonë botën si një fshat global me qëllim sundimin e saj.

Gruaja

Gruaja në familje dhe mes fëmijëve ka të drejtë më të madhe se burri, sepse gratë bartin vështirësi dhe mundime më shumë se burrat, prandaj sa më të shumta të jenë vështirësitë dhe mundimet, aq më e madhe është e drejta e tyre.

Ata thanë se një grua nuk mund të bëhet dijetare apo të marrë pjesë në ndërtimin e jetës duke qenë e mbuluar. Unë pyes këtu: Ku janë aktivitetet shoqërore, në të cilat gratë morën pjesë pas heqjes së mbulesës?

Theksi duhet të vihet në ruajtjen e të drejtave dhe idealeve të grave.

Ne duhet të rishqyrtojmë vlerat dhe standardet aktuale të gruas, të cilat i kanë vendosur regjimet sunduese.

Gruaja është dijetare, politikane, drejtoreshë, personalitet i shquar dhe mbi të gjitha, ajo është bashkëshorte dhe nënë.

Islami qëndroi përballë arabëve para Islamit, që i vrisnin vajzat e tyre, si dhe qëndron përballë popujve të tjerë jomyslimanë që nënvlerësojnë dhe përbuzin gruan.

Islami, në pikëpamjen e tij për çështjen e gruas dhe për rolin e saj individual, familjar, politik dhe shoqëror, është në gjendje t'i thërrasë të gjithë popujt, që të ndjekin udhëzimet e tij (Islamit).

Perëndimorët e kanë tepruar, duke neglizhuar njohjen e natyrës së gruas dhe mënyrën se si të veprojnë me të. Pikëpamja perëndimore për gruan bazohet në pabarazi dhe padrejtësi.

Në vendet perëndimore, pavarësisht parullave që lëshojnë, numri i grave që përballen me rrahje dhe dhunim

nga burrat e tyre dhe numri i vajzave që rrihen dhe plagosen nga duart e baballarëve të tyre, vazhdon të jetë i madh.

Shumë nga ato femra që flasin sot për të drejtat e grave, në fakt, propozojnë lirinë perëndimore dhe shkeljen e të drejtave, si dhe imitojnë perëndimorët.

Nëse versioni perëndimor për gratë do të ishte i saktë, atëherë perëndimorët nuk do të duhej që pas shtatëdhjetë, tetëdhjetë apo njëqind vjetësh, të parashtrojnë një rilindje të re, për të mbrojtur të drejtat e grave, siç po bëjnë kohët e fundit.

Perëndimorët duhet të përgjigjen për atë që u kanë bërë grave, sepse ata i kanë tradhtuar gratë dhe qytetërimi perëndimor nuk u ka ofruar asgjë atyre.

Kultura perëndimore rreth gruas, mosrespektimi dhe çuarja e grave të atyre vendeve drejt vulgaritetit, ka sjellë dobësimin e familjes dhe e ka bërë strukturën e familjes të paqëndrueshme.

Ne duhet të kërkojmë arsyet e padrejtësisë që u ndodhi grave gjatë historisë.

Çdo lëvizje që ngrihet për të mbrojtur gratë, duhet të ketë si shtyllën e saj kryesore dëlirësisë dhe nderin e grave.

Lëvizja drejt njohjes së të drejtave të gruas në shoqërinë islame dhe në shoqërinë tonë është një domosdoshmëri, por duhet të jetë mbi baza islame dhe me qëllim islam.

Islami dëshiron arritjen e pjekurisë intelektuale, shkencore, shoqërore dhe politike dhe mbi të gjitha, udhëzimin e shpirtit dhe të virtytit të gruas, që ky udhëzim të arrijë në nivelin më të lartë.

Ne besojmë se gratë në çdo shoqëri të shëndoshë njerëzore janë të afta dhe duhet të gjejnë mundësinë për të bërë përpjekje dhe për të konkuruar në fushën e përparimit shkencor.

Në mesin e vetë grave duhet të ketë bindje dhe ndërgjegjësim për domosdoshmërinë e të drejtuarit kah përvetësimi i dijes, i të mësuarit, i të lexuarit, i ndërgjegjësimit, i informacionit dhe i njohurive dhe t'i kushtojnë rëndësi kësaj.

Studimi i femrës është shumë i rëndësishëm jo vetëm për të përvetësuar njohuri, por edhe për të ngritur nivelin e pjekurisë intelektuale të saj. Sa i përket punës, ajo është në shkallën e dytë.

Nëse një grua zotëron energji shkencore, për shembull, ose aftësi për të bërë shpikje ose zbulime, ose, nëse ajo është e kualifikuar për të kryer veprimtari politike, ose punë shoqërore dhe nuk i lejohet t'i përdorë këto energji ose t'i zhvillojë ato aftësi, atëherë kjo është e padrejtë.

Nëse shoqëria jonë është në gjendje t'u mësojë grave njohuritë që dëshiron Islami, nuk ka dyshim se vendi do të fitojë një pjesë të shumëfishtë të lartësimit dhe të përparimit.

Çështja kryesore për gratë përmbledhet në ndjenjën e tyre të sigurisë dhe të qetësisë, si dhe në ofrimin e mundësive për lulëzimin e energjive të saj dhe për të mos rënë viktimë e padrejtësisë së shoqërisë, burrit, babait e të tjerë.

Shërbimi ndaj njerëzve

Më e mira që duhet të bëjnë zyrtarët dhe drejtuesit në postet e ndryshme të vendit, është t'i shërbejnë popullit.

Sa më i vështirë të jetë shërbimi ndaj njerëzve, aq më shumë shtohet qetësia shpirtërore e një personi, pas përfundimit të kryerjes së këtij shërbimi.

Republika Islamike, e cila nuk ka qëllim apo filozofi tjetër pas formimit të saj përveçse t'i shërbejë popullit, duhet të ngrejë flamurin e drejtësisë islame.

Çdo punë që u shërben të dobëtëve, ka vlerë të madhe. Dashtë Allahu!

Infermiera

Profesioni i infermierisë është i mahnitshëm, sepse nga njëra anë, ai grumbullon dhembshurinë, mëshirën, keqardhjen dhe vëzhgimin dhe nga ana tjetër, është shkencë, njohuri, përvojë dhe aftësi.

Kjo shkencë (infermiera) duhet të shoqërohet me emocione njerëzore transparente, me ndjenja dashurie, me ndjenja përgjegjësie dhe me përkujdesje e interesim për pacientin.

Nëse ilaçi është dhe mungon mirësjellja, atëherë vetëm ilaçi nuk mund ta shërojë pacientin. Një pjesë e madhe e shërimit të pacientit varet nga duart e buta të infermierëve.

Rinia

Ndihem i lumtur, kur të rinjtë më flasin për çështjen e zbulimit të talenteve dhe të aftësive në të gjithë vendin.

Ju o rini besimtare, kur e përziëni diturinë, besimin, guximin, krijimtarinë dhe shfrytëzimin e mundësive dhe i investoni ato në fushën e shkencës dhe të punës, do të jeni frytet më të mira të kësaj përzierjeje.

Nuk ka dyshim se esenca e rinisë së vendit përfaqësohet te të rinjtë studentë dhe universitarë dhe te studentët e shkencave fetare. Sa më e lartë të jetë ndjenja e përgjegjësisë dhe e punës në këtë shtresë masive e magjepsë, aq më e lartë është vlera e rinisë.

Shkatërrimi i gjithanshëm po vërshon si një përrua i furishëm në drejtim të të rinjve në vendet islame. Rinia e

shkatërruar nuk mendon për reforma. Feja, ana shpirtërore, besimi dhe politika nuk u interesojnë fare atyre.

Në vendet që janë aktualisht në kulmin e zhvillimit shkencor, industrial dhe material, të rinjtë në ato vende ndiejnë dëshpërim, zhgënjim e mungesë shprese. Për këtë arsye janë përhapur në to dukuritë e vetëvrasjes dhe të krimit.

Ne mund të sigurojmë një atmosferë shprese, e shoqëruar me përparim material e shpirtëror dhe me vendosjen e marrëdhënieve të drejta në vend, me kusht që ju o rini të bëni atë që i ka hije brezit tuaj në këtë fazë.

Pjesëmarrja në studime, dëlirësia, nderi dhe heqja dorë nga zbavitjet e kota janë ndër gjërat që duhet të bëjnë të rinjtë.

Nëpërmjet planifikimit, duhet të përgatitet terreni që brezi në rritje, jo vetëm studentët e shkencave fetare, por edhe studentët e tjerë, të bëjnë të mundur leximin e koleksionit të librave të martirit Mutahari.

Brezi ynë i ri duhet të ndërmarrë hapa për të pushtuar majat shkencore, duke u zbukuruar me besim të patundur, me dije dhe të jetë si alpinisti që pushton majat e maleve.

Të rinjtë dhe adoleshentët, të cilët gëzojnë talente të ndryshme, duhet të jenë vigjilentë ndaj tundimeve të armiqve dhe t'i harxhojnë energjitë e tyre në shërbimin dhe lulëzimin e vendit.

Të rinjtë, qofshin studentë, akademikë, punëtorë apo shtresa të tjera, duhet të kuptojnë domosdoshmërinë e ushtrimit të rolit të tyre në të ardhmen.

E ardhmja do të jetë në duart tuaja, o të rinj. Dijeni se, në dashtë Allahu, do të dëshmoni lartësimin e kombeve dhe lavdinë e tyre të vërtetë dhe do të korrni frytet e qëndrueshmërisë suaj.

Fëmijët

Nëse një person sheh fëmijët e të tjerëve në prag të rënies në humnerën e devijimit apo të vulgaritetit, ai duhet ta parandalojë këtë, ashtu siç bën me fëmijët e tij.

Shikojini nënat që i dërguan djemtë e tyre, për hir të Zotit, në frontet e betejës. Ato dukeshin sikur po i çonin në dasmë dhe nuk shqetësoheshin për këtë.

Mos e harroni furnizimin me devotshmëri. Rekomandoni njëri-tjetrin për devotshmëri dhe vigjilencë. Jo vetëm kaq, por, në shtëpi, baballarët dhe nënat t'i rekomandojnë fëmijët e tyre dhe fëmijët t'i rekomandojnë baballarët, nënat, vëllezërit dhe motrat e tyre.

Nënat që dhanë dy, tre dhe katër fëmijë të tyre në rrugën e Allahut, nuk kërkonin një demokraci perëndimore apo një republikë demokratike.

Të rinjtë le të marrin nismën për të krijuar tubime familjare dhe për të mbledhur ndihma nga anëtarët e familjes, që t'i shpenzojnë ato për të varfrit dhe nevojtarët.

Pas vendosjes së sistemit islamik, ne kemi gra madhështore, të cilat arritën të rrisin fëmijë, që janë të gatshëm për t'u sakrifikuar. Ato i ofruan djemtë dhe burrat e tyre për të mbrojtur vendin.

Shteti

Kuptimi i qeverisë alevite është që punëtorët, në çdo cep të sistemit, të bëhen të drejtë, në mënyrë që të jetë e mundur të falin namaz pas secilit prej tyre.

Kur sionistët duan të diskreditojnë Republikën Islamike, thonë për të se është një qeveri islame. Ata imagjinojnë se qeveria islame është një lloj fyerjeje.

Hapi më i vështirë në rrugëtimin e arritjes së qëllimeve islame është krijimi i një qeverie islame.

Nëse krijimi i qeverisë islame përbën një dëm për Islamin, atëherë përse Profeti Muhamed i duroi gjithë ato mundime dhe u përball me gjithë ato luftëra, që çuan në vrasjen e një numri të madh njerëzish?!

Sistemi islam krenohet me ngritjen e parullës së sovranit të devotshmërisë dhe të vlerave morale, ku qeveria nuk përfaqëson dominimin tiran dhe as qeverisja nuk është e bazuar në mashtrim dhe artificialitet.

Qeveria (islame) është kujdestari, dashuri, lidhje zemre dhe besimi. Në vend të standardeve të zakonshme, që aktualisht bazohen në para dhe propagandë të rreme, qeveria islame ka si kriter jurisprudencën dhe drejtësinë.

Republika Islamike, e cila nuk ka asnjë qëllim apo filozofi pas krijimit të saj përveç shërbimit të popullit dhe respektimit të drejtësisë islame, nuk duhet të jetë e pavëmendshme në këtë drejtim.

Prej detyrave të qeverisë islame është që të mos e braktisë popullin dhe të mos e lërë atë të hutuar në udhëkryq të turbullt.

Qeveria duhet të ndiejë ndaj njerëzve të njëjtën ndjenjë që një person ndien ndaj familjes së tij, gruas dhe fëmijëve të tij.

Nuk duhet të keni frikë nga ato akuza dhe thënie se e keni politizuar fenë, e kjo sepse në thelb ju jeni qeveri fetare.

Unë personalisht nuk besoj në fenë e qeverisë, siç ishte feja e Umajadëve dhe Abasidëve, sepse feja është feja e Allahut, që është besim dhe ndjenjë e zemrës. Sa për ju, ju jeni një qeveri fetare, që do të thotë se legjitimiteti juaj buron nga mendimi fetar dhe veprimi fetar.

Qeveria është aktivisti i vërtetë në mbarë vendin dhe çdo sukses i arritur nga qeveria është sukses për sistemin islam.

Nëse qeveria, (*Zoti na ruajt!*), bie në gjumë letargjik, ndalet apo dështon në veprimet e saj të ndryshme, kjo do të konsiderohet si dështim dhe dobësim i origjinës së sistemit.

Nuk është e mundur ta ndash sistemin nga mjetet operative. Nuk është e drejtë të themi se qeveria jonë është e dështuar në planet e saj, por sistemi ynë është efektiv dhe

i suksesshëm. Sukseset e sistemit janë të dukshme në sukseset e arritura nga qeveria, duke qenë se është kyçi kryesor në drejtimin e vendit.

Të kritikosh qeverinë, nuk do të thotë dobësim, por kritika duhet, nëse reflekton kujdes dhe drejtësi.

Unë nuk e ndaloj kritikën, por ndaloj baltosjen dhe shpifjen, sepse në të nuk ka asnjë interes. Askush nuk mund ta bindë veten e tij me shpifjen ndaj qeverisë, në asnjë mënyrë e në asnjë situatë.

Ata që qëndrojnë të bashkuar kundër qeverisë së juristit të drejtë, pranojnë qeverinë e grushteve ushtarake të shtetit dhe qeverinë e kapitalistëve të korruptuar.

Sistemi islam

Imami ynë themeloi sistemin islam, që, në thelb, bazohet në qeverisjen islame dhe mbështetet në sistemet dhe profilet e politikës islame.

Qëllimi i këtij sistemi (sistemi islam) është të mbrojë jetën e këtij populli me modele islame dhe të gjitha orientimet dhe qëllimet e tij t'i bëjë islame.

Për këtë sistem të begatë ka një material bazë, që është besimi te Allahu dhe te e padukshmja (el gajb). Ai ka një kornizë dhe një imazh, me të cilët është i rrethuar, që është ligji islam.

Asnjëherë më parë në botë gjatë historisë nuk është formuar një sistem i tillë, i cili bazohet në besimin te Allahu i Madhëruar e i Lartësuar dhe është i përfshirë në kuadrin e Sheriatit tolerant islam.

Sistemi ynë është një sistem i jashtëzakonshëm dhe i panjohur për njeriun material. Ai është i njohur për myslimanët që kanë njohuri dhe informacion për Kur'anin dhe Islamin.

Askush nuk e ëndërroi vendosjen e sistemit islam në këtë kohë.

Sistemet e tjera nuk i japin asnjë rëndësi fesë së njerëzve dhe jetës së përtëjme. Mes tyre është sistemi islam, që i kushton rëndësi të veçantë edukimit dhe përsosjes së shpirtit.

Sistemi islam është sistemi i drejtësisë dhe çdo padrejtësi në të është e refuzuar. Sistemi islam është sistemi i drejtësisë dhe çdo diskriminim dhe dallim është i refuzuar në të.

Sistemi islam është sistemi i pavarësisë së popullit dhe çdo formë agjente është e refuzuar.

Sistemi islam është sistemi i vëllazërisë dhe i harmonisë mes zemrave të bijve të popullit dhe çdo lloj përçarje në të është e refuzuar.

Sistemi islam është sistemi në të cilin zyrtarët janë shërbëtorë për popullin, janë prej tyre dhe të atyre.

Pushteti i juristit

Pushteti i juristit (Uilajetul Fakih) është një nga postulatet e jurisprudencës shi'ite.

Ajo që disa njerëz, gjysmë të arsimuar, thonë se Imam Khomeini e shpiku vetë idenë e Pushtetit të juristit (Uilajetul Fakih) dhe dijetarët e tjerë nuk e miratuan atë, është për shkak të mosnjohjes së kësaj teme.

Kushdo që është i njohur me mendimet e juristëve, e kupton se Pushteti i juristit (Uilajetul Fakih) është një nga gjërat e qarta në jurisprudencën shi'ite.

Unë, si çdo njëri prej jush, duhet ta mbroj Pushtetin e juristit (Uilajetul Fakih) duke qenë se është shtylla kurrizore e sistemit islam.

Mosmarrëveshja e tyre (kundërshtarëve të Pushtetit të juristit) nuk ishte në dimensionin e pushtetit në të, pasi pushteti nënkupton qeverisjen dhe ata ishin të etur për sundim dhe pushtet, por më tepër mospajtimi i tyre ishte me parimin e juristit, sepse kjo do të thotë prani reale e fesë në shoqëri dhe është ajo që ata nuk e dëshironin.

Qeveria islame dhe Pushteti i juristit sot janë një nga parimet e jurisprudencës islame dhe prej konsideratave racionale.

Shtylla e Imam Khomeinit për qeverisjen e Islamit ishte Pushteti i juristit, që ka një themel të fortë dhe të palëkundur.

Me gjithë mendimet e ndryshme të dijetarëve për ngushtësinë dhe gjerësinë e Pushtetit të juristit, origjina e teorisë është çështje e qartë e jurisprudencës islame.

Pushteti i juristit (Uilajetul Fakijh) ka një themel të fortë dhe Imam Khomeini e parashtoi projektin e tij duke u

bazuar në atë themel, që nënkupton qeverisjen e Islamit, fesë dhe Sheriatit.

Armiqtë e sistemit islam e kanë kuptuar mirë se parimi i Pushtetit të juristit (Uilajetul Fakijh) nuk ka të bëjë me individë, madje as me imamin e ndjerë, Imam Khomeinin.

Politika islame

Imam Khomeini, përmes paraqitjes së doktrinë politike në Islam, autorizoi anulimin e të gjitha aktiviteteve kulturore dhe politike të armiqve të Islamit përgjatë një periudhe prej një shekulli e gjysmë.

Me propozimin, studimin dhe predikimin e doktrinë politike të Islamit u kristalizua drejtimi intelektual dhe logjik për xhihad të gjerë e masiv.

Këshilli i katërt (Këshilli i Konsultimit) e përzjeu politikën me moralin dhe nuk e bëri politikën të jetë në atë drejtim, që bie ndesh me moralin.

Meqenëse politika është prej shtyllës së ligjit dhe gradat e këtyre politikave janë më të larta se ligji, në kuadrin e kushtetutës, nëse nuk ka ndryshim në të, kështu që askush

nuk duhet të punojë apo të predikojë sipas këndvështrimit të tij, nëse ka një pikëpamje ndryshe nga kushtetuta.

Politika, në kuptimin e mashtimit dhe të gënjeshtërsisë së opinionit publik, nuk është ajo politikë që kërkon Islami.

Duhet ta përsërisni këtë fjali: “Politika në Islam nuk ndahet nga feja dhe feja nuk ndahet nga politika”, derisa ta dëgjojnë të gjithë.

Politika e ndarë nga feja është e ndotur, ndërsa politika që buron nga feja, ka një shenjtëri, që e bën atë një model për të gjithë.

Parimi i pandashmërisë së fesë nga politika është një nga kapitujt më të mëdhenj që ka lidhje me sistemin politik të Islamit.

Në këtë kohë po sulmohen çështjet më të dukshme dhe më elementare të parimeve të sistemit politik në Islam. Ata sulmues shtrojnë këtë pyetje: Në parim, a ka lidhje ndërmjet Islamit dhe politikës?

Revolucioni Islamik

Që nga fitorja e Revolucionit Islamik në Iran e deri më sot, armiku ka hedhur dhe vazhdon të hedhë një listë me akuza kundër Iranit Islamik. Janë të njëjta akuza që ai hedh sot kundër të gjitha lëvizjeve islame.

Populli iranian nuk ka devijuar nga linja e Imam Khomeinit dhe as nga linja e Revolucionit. Imam Khomeini triumfoi, pavarësisht vullnetit të armiqve të tij dhe armiqve të Revolucionit.

Imami ynë i madh, së pari, ndoqi në mënyrë të plotë shembullin e Imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*), kështu që ia doli ta çonte revolucionin në bregun e fitores. Së dyti, ai ishte një arsye për të siguruar vazhdimësinë e këtij Revolucionit pas tij.

Linja e Imam Khomeinit (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) është Islami dhe revolucioni. Askush nuk mund ta akuzojë Imamin se ka bërë diçka në kundërshtim me planifikimin e duhur.

Sot, qëllimi kryesor i Amerikës dhe i arrogancës është të detyrojnë revolucionin, Republikën Islamike dhe popullin iranian të tërheqin fjalët e tyre dhe fjalët e Imam Khomeinit.

Nëse të gjithë njerëzit e arsyeshëm të botës do të hulumtonin e do të analizonin, do ta kishin kuptuar se rruga e rregullt është rruga e ndjekur nga ai njeri (Imam Khomeini). Ajo është rruga që të çon në qëllimet e saj.

Mediet e armikut po përpiqen ta portretizojnë mesazhin e Revolucionit sikur të jetë bërë një gjë e vjetërsuar në botë.

Sot, emri i këtij Revolucionit dhe i kësaj lëvizjeje të madhe të popullit tonë dhe rrugëtimi i dukshëm i Imam Khomeinit dëshmohet në skajet më të largëta të botës.

Revolucioni nuk është i lidhur me një kohë të caktuar, që të dobësohet shpirti revolucionar, thjesht, duke u larguar nga ajo kohë (nga koha e kryerjes së Revolucionit).

Revolucioni ynë nuk u bëri thirrje vetëm myslimanëve, që të kthehen në Islam, por ishte i dobishëm edhe për të krishterët. Kjo ishte premisa e rënies së Perandorisë Lindore dhe e rënies së qeverisë marksiste në botë.

Ajo që tërheq vëmendjen, në radhë të parë, në nivelin e botës islame, është se Revolucioni Islamik, dyzet e katër vjet pas fitores së tij, tërheqja ndaj tij dhe reflektimet e tij, janë bërë më të forta.

Revolucioni ynë i madh Islamik dhe ky uragan i stuhishëm, i cili tronditi pallatet e shtypjes në botë, sot ka arritur një fazë pjekurie.

Pas fitores së Revolucionit Islamik shoqëria jonë e ndjeu identitetin e saj.

Ne ishim të humbur në mes të dallgëve të baticave ndërkombëtare, ndaj Revolucioni erdhi për të na ringjallur dhe për të na dhënë personalitet.

Revolucioni na mësoi se çdo popull mund ta thotë fjalën e tij dhe të ketë qëndrimin e tij për çështjet më të rëndësishme globale.

Revolucioni nuk ishte një çështje e lehtë, por erdhi si fryt i një kryengritjeje që vazhdoi pesëmbëdhjetë vjet.

Shumë njerëz nuk besonin në Islam, por falë atij Revolucioni filluan të besojnë në të.

Shumë vajza nuk e njihnin hixhabin, por në kohën e Revolucionit ato filluan ta mbajnë hixhabin, pa i urdhëruar askush.

Ky Revolucion bazohet në parime të forta, të palëkundura, që nuk kanë lidhje as me parimet e Socializmit, as me parimet e Kapitalizmit liberal.

Të gjithë ata që janë në arenën politike të vendit, duhet t'u besojnë vlerave dhe rregullave bazë të këtij Revolucion.

Thënie të ndryshme

- ✚ Nuk ka dritë tjetër përveç Allahut. Ai është drita absolute dhe çdo gjë është errësirë. Prandaj, të gjithë qëndroni në detin e Sunduesit, në detin e Profetësisë dhe në detin e Kur'anit dhe zhytuni në thellësitë e tyre.

- ✚ Të drejtuarit kah diçka tjetër përveç Allahut, e mbulon njeriun me mbulesën e errësirës. E gjithë bota është në praninë e Allahut dhe Ai është në dijeni për gjithçka që ndodh.

- ✚ Të gjitha fatkeqësitë që kanë rënë mbi këtë vend, erdhën prej të paditurve, që nuk kishin njohuri për Islamin. Islam do të thotë që ne të sakrifikojmë të gjithë, deri sa atij t'i jepet mundësia e praktikimit.

- ✚ Nëse do t'ia prezantoni botës Islamin, ashtu siç e meriton dhe, nëse e zbatoni ashtu siç është, atëherë pavarësia dhe lartësimi do të jetë pjesë e juaja.

- ✚ Të dashurit e mi! Le të zhvishemi prej petkut të djallit dhe të vishemi me petkun e të Gjithëmëshirshmit. Kjo të bëhet duke vepruar sipas sistemit islam.

- ✚ Të dashurit e mi! Edukojini veten tuaj dhe bëhuni të sjellshëm, sepse kjo dynja nuk është e qëndrueshme dhe të gjithë do të largohemi prej saj, unë e pastaj ju.

- ✚ Dijeni se, sikur një ditë të heqim dorë nga mbështetja te Allahu dhe të mbështetemi te nafta apo te armët, kjo do të jetë dita e drejtimit kah mposhtja. Ne kurrë nuk frikësohemi, sepse veprojme për hir të Allahut.

- ✚ O myslimanë të botës dhe ju njerëz të shtypur, që jeni nën autoritetin e zullumqarëve! Ngrihuni, bashkohuni dhe mbroni Islamin dhe pasurinë tuaj! Mos iu frikësoni zhurmës së kryelartëve!

- ✚ Nuk është problem numri i paktë, nëse keni besim të fortë. Shkaku i të gjitha fatkeqësive është besimi dhe bindja e dobët.

- ✚ Përderisa populli ynë vazhdon të jetë i drejtuar kah Allahu, unë jam i bindur se asnjë fuqi nuk mund t'i bëjë keq atij dhe as nuk mund ta dëmtojë. Nëse qëndrojmë të fortë e të palëkundur, pa dyshim që do të kemi mbështetjen hyjnore.

- ✚ Predikimi për përhapjen e dritës së Islamit duhet të bazohet te logjika, intelekti, të menduarit, te sinqeriteti dhe vlerat shpirtërore. Pra, predikimi duhet të burojë nga burimi i dritës.

- ✚ Mos u interesoni shumë për pamjet e shtëpive tuaja dhe as për mënyrën e të jetuarit tuaj, por kujdesuni për ato që ju realizojnë krenarinë njerëzore dhe për shembullin që ju realizon juve triumfin.

- ✚ Bashkësia islame beson fort në parullën “as mos bëj padrejtësi e as të mos të bëhet padrejtësi”. Sakrifica

për revolucionin e madh është tregues i triumfit dhe i afrimit të qëllimi.

- ✚ Ruani kufijtë e Islamit dhe mos e keqpërdorni lirinë, sepse liria është e kufizuar me kufijtë e Islamit.

- ✚ Vëllezërit e mi, motrat e mia! Nëse dëshironi të fitoni krenarinë në këtë dynja dhe në Ahiret dhe të jetoni me nder, atëherë qëndroni të fortë dhe të palëkundur përballë të huajve dhe bëhuni të mëshirshëm dhe të butë me njëri-tjetrin.

- ✚ Populli që nuk ka udhërrëfyes, është i paaftë për çdo gjë.

- ✚ Zgjahuni dhe zgjojini të fjeturit dhe të “vdekurit”. Sakrifikoni nën flamurin e monoteizmit, për të mos ushqyer intrigat e kolonialistëve, si dhe të paguarit e tyre të pavlerë.

- ✚ Të shumtë janë pretenduesit e besimit, por të paktë janë besimtarët.

- ✚ Duhet t'i kryejmë detyrat tona. Vërtet, Allahu i Madhëruar nuk i ngarkon njerëzit veçse aq sa kanë mundësi.

- ✚ I dashuri im! Nëse në dynja shikon të keqen, më e pakta që mund të bësh, është të mos e kërkosh dynjanë prej krijesës së dobët si ti.

- ✚ Ne duhet ta bindim veten tonë se jemi njerëz, jemi të pranishëm në këtë dynja, Lindja është vend në tokë dhe se Perëndimi nuk është e gjithë toka (bota).

- ✚ Armiku i brendshëm, i cili është më i rrezikshëm se armiku i jashtëm. Ato janë cilësitë e këqija, si: dembelizmi, mungesa e energjive në punë, gjunjëzimi, mendjemadhësia, paragjykimi ndaj të tjerëve, mosbesimi në vetvete etj. Të gjitha këto janë sëmundje. Armiqtë e jashtëm janë përpjekur dhe përpiqen gjithmonë që këto cilësi negative t'i

përhapin në mesin e shoqërisë islame, me qëllim që t'i largojnë myslimanët nga mësimet e pastra islame.

✚ Armiku i jashtëm është arroganca globale, e cila dëshiron të sundojë mbarë botën sipas ligjeve të saj të posaçme. Sot ky armik është i trupëzuar në sionizmin botëror dhe në shkatërrimin amerikan.

✚ Singeriteti është një prej faktorëve dhe karakteristikave shumë të rëndësishme në sjelljen e njeriut. Kushdo që e ka, vlerësohet në mënyrën më të mirë.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje.....	5
Profetësia dhe qëllimi i profetëve (Paqja qoftë mbi ta!).....	7
Profetët e Allahut.....	13
Isai (Paqja qoftë mbi të!), Profeti i Allahut.....	14
Ehli Bejti (Paqja qoftë mbi ta!).....	16
Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!).....	17
E sinqertja e madhe, Fatime Zehraja (Paqja qoftë mbi të!)...25	
Imam Hasani (Paqja qoftë mbi të!).....	29
Imam Hysejini (Paqja qoftë mbi të!).....	31
Zonja Zejneb (Paqja qoftë mbi të!).....	38
Mbulimi (hixhabi).....	40
Udhëheqja (El Uilajetu).....	42

Gadiri.....	44
Shi'izmi.....	46
Ashurja.....	47
Media.....	55
Globalizimi.....	59
Gruaja.....	62
Shërbimi ndaj njerëzve.....	68
Infermiera.....	69
Rinia.....	70
Fëmijët.....	73
Shteti.....	75
Sistemi islam.....	79
Pushteti i juristit.....	82
Politika islame.....	85
Revolucioni Islamik.....	87
Thënie të ndryshme.....	91
Përmbajtja e lëndës.....	97

الدروس النورانية

مقتبسات من كلمات القصار لآية الله العظمى السيد علي الخامنئي دام ظله

تيرانا 2023

اسم الكتاب: الدروس النورانية

مقتبسات من كلمات القصار لآية الله العظمى السيد علي الخامني دام ظله

المترجم: الحاج ولنت مريا

التصحيح الأدبي: يريدا كولا

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا